



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 183 dt.26.08.1994

**MBI**  
**RRITJEN E PAGES MUJORE TË KESHILLAVE DREJTUESE TË**  
**NDERMARRJEVE LOKALE**

Këshilli Bashkiak i Qytetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.26.08.1994, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura nga aparati administrativ i Bashkisë për miratimin e disa ndryshimeve në rritje të pagës së Këshillave Drejtuese të disa ndërmarrjeve të varësisë së Ministrisë së Ndërtimit, në zbatim të ligjit Nr.7582, dt.13.07.1992 “Për ndërmarrjet ekonomike”, neni.19, pika.5 dhe të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal ” neni.14, pika.10;

**VENDOSI**

1. Pagat e drejtorëve të Këshillave Drejtuese të jenë :

- |  |                    |
|--|--------------------|
| 1.Drejtori i Nd. Metalike “Dajti”                        | 5.334 lekë në muaj |
| 2.Drejtori i Nd. së Montimeve Tiranë                     | 5.842 lekë në muaj |
| 3.Drejtori i Nd.Transportit<br>Makinerive të Transportit | 4.953 lekë në muaj |
| 4.Drejtori i Nd. Dekor Funeralit                         | 6.477 lekë në muaj |

- |   |                    |
|---|--------------------|
| 5.Drejtori i Nd. së Prodhimeve të Apartamenteve     | 5.461 lekë në muaj |
| 6.Drejtori i Nd. Lëndës Djegëse                     | 4.826 lekë në muaj |
| 7.Drejtori i Nd. Ndërtim Banesa                     | 7.264 lekë në muaj |
| 8.Drejtori i Nd. Komunale Prodhim Material Ndërtimi | 4.826 lekë në muaj |
| 9.Drejtori i Byrosë së Studimeve dhe Projektimeve   | 4.826 lekë në muaj |
2. Pagat e Kryetarëve të Këshillave Drejtuese (në rastet kur Drejtori i ndërmarrjes nuk është Kryetar i Këshillit Drejtues) përmirësimi në rritje të pagës do të jetë 27 përqind.
  3. Anëtari i Këshillit Drejtues që njëkohësisht kryen detyrën e Krye Inxhinierit ose të Kryetarit të Degës 20 përqind.
  4. Anëtar i Këshillit Drejtues që kryen detyrën e specialistit 15 përqind.
  5. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993 drejtori i ndërmarrjes dhe anëtarët e Këshillit Drejtues përfitojnë rritje mbi pagë (kur plotësojnë kushtet, shiko vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.623) mbi 5 deri në 50 përqind në të njëjtën masë që do të përfitojnë punonjësit e tjerë të ndërmarrjes.
  6. Këto paga sipas listës së më sipërme do të zbatohen që nga Janari i vitit 1994.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**